

Thirrja është e hapur nga data 13.03.2026 deri me 23.03.2026

TERMAT E REFERENCËS

ARANZHMAN PËR REALIZIMIN E AKTIVITETEVE TË ORGANIZATËS “NEVO KONCEPTI”

Organizata	OJQ “NEVO KONCEPTI”
Objektiva	Sigurimi i transportit, akomodimit dhe ushqimit për realizimin e aktiviteteve të organizatës “Nevo Koncepti”

1. Të dhënat për Organizatën

OJQ “Nevo Koncepti” është organizatë joqeveritare e themeluar më 26 Nëntor 2014. Në themelimin e OJQ “Nevo Koncepti” kanë marrë pjesë intelektual të komunitetit Romë të cilët për shumë vite janë angazhuar në forma të ndryshme dhe kanë kontribuar në fuqizimin dhe avancimin e pozitës së komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian në pjesë të ndryshme të Kosovës sikurse në Prizren, Gjakovë, Ferizaj, Pejë, Rahovec, Fushë Kosovë, Suharekë, Prishtinë, Mitrovicë, Klinë etj.

OJQ “Nevo Koncepti” bashkëpunon me fëmijë, të rinjë dhe familje të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian, me institucionet publike qendrore dhe lokale, organizata të shumta vendore dhe ndërkombëtare, media dhe palë tjera me interes.

2. Përshkrimi i shërbimeve të kërkuara

Transporti

- Organizimi i transportit me autobus komod deri në Durrës dhe kthimi në Kosovë.
- Pjesëmarrësit duhet të merren nga qytetet: Ferizaj, Prishtinë, Gjakovë, Klinë, Pejë dhe Prizren.
- Itinerarin e udhëtimit e organizon agjencia.
- Në kthim, pjesëmarrësit duhet të kthehen në të njëjtat lokacione nga ku janë marrë.
- Të ofrohet nga një kafe për secilin pjesëmarrës gjatë udhëtimit në vajtje dhe gjatë kthimit.

Mirëpritja dhe organizimi

- Mirëpritja dhe asistenca për stafin dhe pjesëmarrësit që do të marrin pjesë në aktivitetin që do të zhvillohet në ambientet e hotelit.

Akomodimi

- Akomodim për rreth 30 persona gjatë datave 03–06 prill 2026.
- Akomodimi të realizohet në:
 - 6 dhoma një-she
 - 12 dhoma dy-she

Numri i pjesëmarrësve mund të ndryshojë për (+/-) 5 persona. Numri final i dhomave do të konfirmohet me kohë.

Ushqimi

- Sigurimi i shujtave sipas këtij plani:
 - 3 mëngjese
 - 4 dreka
 - 3 darka

Salla e konferencës

- Sigurimi i një salle konference me kushte optimale për punë, duke përfshirë:
 - Projektor
 - Qasje në WiFi
 - 6 pauza kafeje gjatë aktivitetit.

3. Kushtet e pagesës

Pagesa e shërbimeve do të realizohet pa TVSH, pasi Organizata “Nevo Koncepti” është e liruar nga TVSH.

4. Afati kohor

Konfirmimi final për ofertën dhe numrin e pjesëmarrësve do të bëhet me kohë, në përputhje me marrëveshjen ndërmjet palëve.

5. Rezultatet e pritshme

- Bashkëpunim profesional dhe korrekt ndërmjet palëve.
- Çmimet e ofruara të mbeten të pandryshuara gjatë periudhës së kontratës.
- Dhomat dhe salla e konferencave të përmbushin kushtet optimale për funksionin e tyre.
- Ushqimi të jetë i freskët dhe i përgatitur sipas standardeve të cilësisë.

6. Procedura e aplikimit

Të gjithë të interesuarit duhet t’i dërgojnë këto dokumente:

- Kërkesa për ofertë (të jetë e nënshkruar dhe e vulosur)
- Oferta (të jetë e nënshkruar dhe e vulosur)
- Kopja e regjistrimit të biznesit me numër unik identifikues

Aplikimi duhet të dërgohet jo më larg se data **23.03.2026** në adresën elektronike prokurimi@nevokoncepti.org